Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera. Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera janë njohur fillimisht me vlerë të drejtë dhe në vazhdim mbarten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre. Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre përfshijnë paratë në arkë dhe depozitat rrjedhëse në banka apo investime të tjera likuide afatshkurtra me maturitet origjinal tre muaj ose më pak. Mjetet monetare dhe ekuivalente me to mbahen në KA sepse: (i) ato mbahen për mbledhjen e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale dhe këto flukse monetare kontraktuale reflektojnë VPPI (ii) dhe nuk janë të dizenuara me VDNFH.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet në vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital.

Detyrimet financiare – kategoritë e matjes. Detyrimet financiare klasifikohen si të matura në KA, përveç (i) detyrimeve financiare të matura me VDNFH: ky klasifikim aplikohet për derivativet, detyrimet financiare të mbajtura për shitje (p.sh. pozicionet afatshkurtra me letra me vlerë), shuma e kushtëzuar e njohur nga një blerës në një kombinim biznesi dhe detyrime të tjera financiare të përcaktuara si të tilla në njohjen fillestare dhe (ii) kontratat e garancisë financiare dhe angazhimet e huasë.

Detyrimet financiare – çregjistrimi. Detyrimet financiare çregjistrohen kur ato likuidohen (d.m.th. kur detyrimi i specifikuar në kontratë paguhet, anulohet ose skadon).

Një shkëmbim ndërmjet Shoqërisë dhe huadhënësve të saj të origjinës të instrumenteve të borxhit me kushte shumë të ndryshme, si dhe modifikime thelbësore të termave dhe kushteve të detyrimeve financiare ekzistuese, llogariten si shlyerje e detyrimit financiar fillestar dhe njohja e një detyrimi të ri financiar. Kushtet janë thelbësisht të ndryshme në qoftë se vlera e skontuar e flukseve të mjeteve monetare sipas kushteve të reja, duke përfshirë çdo pagesë të paguar neto nga çdo tarifë e marrë dhe zbritur duke përdorur normën fillestare të interesit efektiv, është të paktën 10% ndryshe nga vlera aktuale e skontuar e flukset monetare të mbetura të detyrimit financiar fillestar. Nëse një shkëmbim i instrumenteve të borxhit ose modifikimi i kushteve llogaritet si shlyerje, çdo shpenzim ose tarifë e shkaktuar njihet si pjesë e fitimit ose humbjes në shlyerje. Nëse shkëmbimi ose modifikimi nuk llogaritet si shlyerje, çdo shpenzim ose tarifë e shkaktuar rregullon vlerën kontabël të pasivit dhe amortizohet gjatë afatit të mbetur të detyrimit të modifikuar.

Ndryshimet e detyrimeve që nuk rezultojnë në shlyerje llogariten si një ndryshim në vlerësim duke përdorur një metodë kumulative mbledhjeje, me çfarëdo fitimi ose humbjeje të njohur në ardhura dhe shpenzime, përveç nëse përmbajtja ekonomike e diferencës në vlerat bartëse i atribuohet kapitalit transaksion me pronarët.

Kompesimi i instrumenteve financiare. Aktivitetet dhe detyrimet financiare kompesohen dhe shuma neto raportohet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për netimin e shumave të njohura dhe ekziston qëllimi për shlyerje në baza neto ose realizimin e aktivitetit dhe shlyerjen e detyrimit në të njëjtën kohë. Kjo e drejtë kompesimi (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjrisht e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast mospagëse dhe (iii) në rast të paaftësisë paguese ose falimentimit.

Llogaritë e pagueshme dhe të tjera. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera njihen kur pala tjetër përmbush detyrimet e saj të performancës sipas kontratës dhe matet fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas mbahet me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Detyrime për qiratë

Detyrimet për qiranë maten në bazë të aktualizimit të flukseve të ardhshme dalëse monetare. Detyrimet për qiranë përfshijnë vlerën aktuale të pagesave të mëposhtme:

- pagesa fikse, të pakësuara nga çdo stimul qiraje të marrë,
- pagesat variabël të qirasë të cilat varen nga një indeks ose normë, e matur fillimisht duke përdorur një indeks ose normë në datën e fillimit,
- shumat e pritshme për t'u paguar nga Shoqëria sipas vlerës së mbetur të garancive,
- çmimi i ushtrimit të opsionit të blerjes nëse Shoqëria është e sigurt për ushtrimin e këtij opsioni, dhe
- pagesat e penaliteteve për përfundimin e qirasë, nëse Shoqëria mendon ta ushtrojë këtë opsion.

Mundësitë e shtyrjes dhe përfundimit janë të përfshira në një numër të konsiderueshëm të qirave për aktivitetet e Shoqërisë. Këto kushte përdoren për të maksimizuar fleksibilitetin operacional në menaxhimin e aktiveve që Shoqëria përdor për operacionet e saj. Pjesa më e madhe e opsioneve të shtyrjes dhe përfundimit janë të ushtrueshme vetëm nga ana e Shoqërisë dhe jo nga qiradhënësi. Opsionet e shtyrjes janë përfshirë në periudhën

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

e qirasë nëse qiraja është në mënyrë të arsyeshme e mundur për tu shtyrë (ose për mos u përfunduar). Pagesat e qirasë që i përkasin periudhës së shtyrjes janë të përfshira në llogaritjen e detyrimit për qiranë financiare.

Pagesat për qiranë janë të aktualizuara duke përdorur normën e përcaktuar në kontratën e qirasë. Nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet lehtësisht, që është dhe rasti i qirave të Shoqërisë, përdoret norma e huamarrjes e cila është norma me të cilën Shoqëria do të duhej të merrte hua fonde për të blerë aktive me vlerë sa vlera e aktivit me të drejtë përdorimi në një mjedis ekonomik të ngjashëm dhe me kushte apo kolateral të ngjashëm.

Për të përcaktuar normën e huamarrjes, Shoqëria:

- kur është e mundur, përdor si pikë fillestare, financimin e fundit të palëve të treta të marra nga qiramarrësi individual, të përshtatur për të reflektuar ndryshimet nga momenti që financimi është marrë,
- përdor një normë interesi pa rrezik, e ndryshuar duke marrë parasysh rrezikun e kreditit, dhe
- bën ndryshime specifike në lidhje me qiranë, për shembull termat, vendin, monedhën dhe kolateralin

Shoqëria është e ekspozuar ndaj një rritje të mundshme në të ardhmen të pagesave të ndryshueshme të qirasë të bazuara në një indeks apo normë, të cilat nuk janë të përfshira në detyrimin për qiranë derisa të hyjnë në fuqi. Kur pagesat e ndryshueshme të qirasë të bazuara në një indeks apo normë hyjnë në fuqi, detyrimi për qiranë rrillogaritet dhe ndryshohet kundrejt aktivit me të drejtë përdorimi.

Qiraja operative. Kur Shoqëria është qiradhënëse në një qira e cila nuk transferon të gjitha rreziqet dhe përfitimet tek qiramarrësi, pagesat e qirasë njihen si të ardhura të tjera në baze lineare.

Huatë. Huatë njihen fillimisht me vlerën e drejtë, duke zbritur kostot e transaksionit dhe më pas mbahen me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Garancitë financiare. Garancitë financiare janë kontrata të parevokueshme që kërkojnë nga Shoqëria që të bëjë pagesa të caktuara për të rimbursuar mbajtësin e garancisë për një humbje që ka për shkak se një debitor i specifikuar nuk arrin të bëjë pagesën në kohën e duhur në përputhje me kushtet e një instrumenti borxhi. Garancitë financiare fillimisht njihen me vlerën e tyre të drejtë, e cila normalisht evidentohet nga shuma e tarifave të pranuar. Kjo shumë amortizohet në bazë lineare gjatë jetës së garancisë. Në fund të secilës periudhë raportuese, garancitë maten me vlerën më të lartë midis (i) shumës së lejuar së humbjes për ekspozimin e garantuar të përcaktuar bazuar në modelin e pritur të humbjes dhe (ii) gjendja e mbetur e paamortizuar së shumës në njohjen fillestare.

Instrumente të tjera financiare

Instrumentet financiare jo-derivative maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit minus humbjet nga zhvlerësimi.

Provigjonet

Provigjonet për detyrimet janë detyrime jofinanciare me kohë ose shuma të pasigurta. Ato janë përllogaritur kur Shoqëria ka një detyrim aktual ose konstruktiv si rezultat i ngjarjeve të kaluara, është e mundur që një dalje e burimeve që përfshijnë përfitimet ekonomike do të kërkojë për të shlyer detyrimin dhe një vlerësim i besueshëm i shumës së detyrimit mund të bëhet. Provigjonet maten me vlerën aktuale të shpenzimeve që pritet të kërkojë për të shlyer detyrimin duke përdorur një normë para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të detyrimit. Rritja në provigjon për shkak të kalimit të kohës njihet si një shpenzim interesi.

Taksat dhe detyrimet, të tilla si tatimi përveç tatimit mbi të ardhurat ose tarifatat rregullatore të bazuara në informacionet që lidhen me një periudhë para lindjes së detyrimit për të paguar, njihen si detyrime kur ndodh ngjarja detyruese që shkakton pagesën e taksës, siç përcaktohet nga legjislacioni që shkakton detyrimin për të paguar taksën. Nëse një taksë paguhet përpara ngjarjes detyruese, ajo njihet si parapagim.

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Njohja e të ardhurave

Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose të arkëtueshme dhe përfaqësojnë shumat e arkëtueshme për mallrat e furnizuara, të deklaruar neto nga zbritjet, kthimet dhe tatimet mbi vlerën e shtuar.

Shoqëria njih të ardhurat kur shumat e të ardhurave mund të maten me besueshmëri; kur është e mundur që përfitimet ekonomike të ardhshme do të rrjedhin tek njësia ekonomike; dhe kur janë përmbushur kriteret specifike për secilën nga aktivitetet e Shoqërisë, siç përshkruhet më poshtë. Kur vlera e drejtë e mallrave të marra në një transaksion shkëmbimi nuk mund të matet në mënyrë të besueshme, të ardhurat maten me vlerën e drejtë të mallrave ose shërbimit të dhënë.

Shitjet e mallrave. Të ardhurat nga shitja e mallrave njihen në pikën e transferimit të rreziqeve dhe përfitimeve të pronësisë së mallrave, normalisht kur mallrat janë dërguar. Nëse Shoqëria pranon të transportojë mallra në një vend të caktuar, të ardhurat njihen kur mallrat i kalojnë klientit në pikën e dorëzimit.

Shitjet e shërbimeve. Shitjet e shërbimeve njihen në periudhën kontabël në të cilën shërbimet kryhen duke iu referuar fazës së përfundimit të transaksionit specifik të vlerësuar në bazë të shërbimit aktual të ofruar si pjesë e shërbimeve totale që duhet të ofrohen.

Të ardhurat nga interesi. Të ardhurat nga interesi njihen në bazë të përqindjes kohore duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Përfitimet e punonjësve

Gjatë rrjedhës normale të ecurisë së biznesit, Shoqëria bën pagesa në emër të saj dhe punonjësve për kontribute sociale dhe shëndetësore, të cilat janë të detyrueshme sipas legjislacionit shqiptar. Këto kosto lindin në emër të Shoqërisë dhe njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes në kohën e ndodhjes.

Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përbëhen nga të ardhurat nga interesi në fondet e investuara në depozitat bankare dhe të ardhurat nga kursi i këmbimit.

Kostot financiare përbëhen nga shpenzimet e interesit për huatë, shpenzimet nga kurset e këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare në fitim ose humbje nga rënia e vlerës së aktiveve financiare.

Humbjet ose fitimet në kursin e këmbimit janë paraqitur në neto.

Shpenzimet e tatimit fitimit

Tatimet mbi fitimin janë parashikuar në pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin e miratuar ose të nxjerrë në mënyrë substanciale deri në fund të periudhës raportuese. Ngarkesa e tatimit mbi fitimin përbën tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë dhe njihet në fitim ose humbje për vitin, përveç nëse ajo njihet në të ardhura të tjera përmbledhëse ose drejtpërdrejt në kapital sepse lidhet me transaksionet që njihen gjithashtu, në të njëjtën ose në një tjetër periudhë, në të ardhura të tjera përmbledhëse ose direkt në kapital.

Tatimi aktual është shuma që pritët të paguhet ose të rimburohet nga autoritetet tatimore në lidhje me fitimet ose humbjet e tatueshme për periudhat aktuale dhe të mëparshme. Fitimet ose humbjet e tatueshme bazohen në vlerësimet nëse pasqyrat financiare janë të autorizuar para se të dorëzojnë deklaratat përkatëse tatimore. Tatimet përveç të ardhurave regjistrohen brenda shpenzimeve operative.

Tatimi i shtyrë i fitimit sigurohet duke përdorur metodën e pasivit të bilancit për humbjet tatimore të bartura dhe diferencat e përkohshme që lindin midis bazës tatimore të aktiveve dhe pasiveve dhe vlerave të tyre kontabël për qëllime të raportimit financiar. Në përputhje me përjashtimin fillestar të njohjes, tatimet e shtyra nuk regjistrohen për diferencat e përkohshme në njohjen fillestare të një aktivi ose një pasivi në një transaksion tjetër nga një kombinim biznesi nëse transaksioni, kur regjistrohet fillimisht, nuk ndikon as në kontabilitet, as fitim të tatueshëm. Shumat tatimore të shtyra janë matur me normat tatimore të miratuara ose të vendosura në fund të periudhës raportuese, të cilat pritët të zbatohen në periudhën kur do të ndryshojnë diferencat e përkohshme ose do të përdoret humbja tatimore përpara.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme dhe humbjet tatimore që barten në të ardhurat regjistrohen vetëm deri në masën që është e mundur që diferenca e përkohshme të kthehet në të ardhmen dhe ekziston fitimi i mjaftueshëm i ardhshëm i tatueshëm në të cilin mund të shfrytëzohen zbritjet.

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Aktivitetet dhe detyrimet tatimore të shtyra kompensohen kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për kompensimin e aktiveve tatimore aktuale kundrejt detyrimeve tatimore aktuale dhe kur aktivitetet dhe detyrimet e tatimit të shtyrë të të ardhurave kanë të bëjnë me tatimet mbi të ardhurat e mbledhura nga i njëjti autoritet tatimor në njësinë e njëjtë tatimore ose subjekte të ndryshme të tatueshme ku ka një qëllim për të shlyer gjendjet në baza neto.

Shoqëria në vitin 2018 ka njohur aktive tatimore të shtyra për humbjet e mbartura nga 31 dhjetor 2016 (31,483,057 lekë) në shumën 4,722,459 lekë, të cilat u sistemuan në rezultatin e vitit 2019, ku nuk mund të mbartet për në vitet në vazhdim pasi kaloi periudha 3 vjeçare e mbartjes së humbjes.

Tatimi mbi vlerën e shtuar

Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) të produktit që lidhet me shitjet paguhet tek autoritetet tatimore në momentin më të herët nga (a) mbledhja e të arktueshmeve nga konsumatorët ose (b) dërgimin e mallrave ose shërbimeve ndaj klientëve. TVSH-ja e inputeve në përgjithësi mund të rikthehet kundrejt TVSH-së së prodhimit pas marrjes së faturës së TVSH-së. Autoritetet tatimore lejojnë shlyerjen e TVSH-së në baza neto. TVSH-ja në lidhje me shitjet dhe blerjet njihen në pasqyrën e pozicionit financiar në baza neto. Kur është bërë provigjoni për zhvlerësimin e të arktueshmeve, humbja nga zhvlerësimi regjistrohet për shumën bruto të debitorit, duke përfshirë TVSH-në.

3. Vlerësimet kritike të kontabilitetit dhe gjykimet në zbatimin e politikave të kontabilitetit

Shoqëria bën vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shumën e njohura në pasqyrat financiare dhe vlerat kontabël të aktiveve dhe pasiveve brenda vitit të ardhshëm financiar. Vlerësimet dhe gjykimet vlerësohen vazhdimisht dhe bazohen në përvojën e menaxhimit dhe në faktorë të tjerë, duke përfshirë pritjet e ngjarjeve të ardhshme që besohet të jenë të arsyeshme sipas rrethanave. Menaxhimi gjithashtu bën gjykime të caktuara, përveç atyre që përfshijnë vlerësime, në procesin e zbatimit të politikave kontabël. Gjykimet që kanë efektin më të rëndësishëm në shumën e njohura në pasqyrat financiare dhe vlerësimet që mund të shkaktojnë një rregullim domethënës në vlerën kontabël të aktiveve dhe pasiveve brenda vitit të ardhshëm financiar përfshijnë:

Parimi i vijimësisë. Drejtimi i Shoqërisë ka përgatitur këto pasqyra financiare mbi bazën e parimit të vijimësisë. Në bazë të këtij gjykimi, Drejtimi konsideroi pozicionin financiar të Shoqërisë, Fitimin operacional, planet e biznesit dhe burimet financiare, dhe analizoi ndikimin e zhvillimeve makroekonomike në operacionet e Shoqërisë, përfshirë ngjarjet pas periudhës së raportimit (Shënimi 27).

Shoqëria ka patur humbje prej 969,605 Lekë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 (2018 fitim: 12,650,946 Lekë), si dhe detyrimet e saj aktuale tejkalojnë aktivet aktuale me 182,570,174 Lekë më 31 dhjetor 2019 (2018: 226,203,491 Lekë).

Shoqëria vazhdon të gjenerojë flukse hyrëse parash nga aktivitetet e saj operative në vitin 2019 dhe pret që të vazhdojë edhe në të ardhmen. Shoqëria ishte në gjendje të gjeneronte fitim përpara tatimit prej 3,752,854 Lekë (2018: 7,928,487 Lekë). Drejtimi beson se Shoqëria do të vazhdojë aktivitetin e saj për të ardhmen e parashikueshme dhe do të jetë në gjendje të realizojë aktivitetet dhe detyrimet dhe angazhimet e saj në rrjedhën normale të biznesit. Prandaj, këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e parimit të vijueshmërisë.

Përveç kësaj, detyrimet tregtare aktuale janë marrë ekskluzivisht nga shoqëria mëmë Sidenor Steel Industry S.A, dhe për limitin e kredisë me bankën Alpha. Shoqëria ka premtuar të gjithë inventarin dhe shumën e të arktueshmeve si garanci për pagesën e detyrimit të saj të ardhshëm. Rrjedhimisht, Shoqëria nuk është e ekspozuar për likuidimin e detyrimeve të saj.

Zhvlerësimi i të arktueshmeve tregtare dhe të tjera. Shoqëria zbaton metodën e thjeshtuar të SNRF 9 për matjen e humbjeve të pritshme të kredisë që përdor një humbje të pritshme për të gjitha të arktueshmet tregtare dhe të tjera. Për të matur humbjet e pritshme të kredisë. Të arktueshmet tragëtare dhe të arktueshmet e tjera janë grupuar në bazë të karakteristikave të përbashkëta të rrezikut të kredisë dhe ditëve të kaluara. Normat e pritshme të humbjeve bazohen në profilet e pagesave të shitjeve gjatë një periudhe dhe humbjet historike përkatëse të kreditit të ndodhura brenda kësaj periudhe. Normat historike të humbjeve janë përshtatur për të pasqyruar informacionin aktual dhe të ardhshëm të faktorëve makroekonomikë që ndikojnë në aftësinë e klientëve për të shlyer llogaritë e të arktueshmeve. Pagesa e humbjes së kredisë për llogaritë e të arktueshmeve dhe të të tjera përcaktohet sipas matricës së provizionit, niveleve të humbjeve dhe HPK për vitin që përfundon 2019.

4. Adaptimi i standardeve të reja dhe interpretimeve të rishikuara

SNRF 16, Qiratë (publikuar më 13 Janar 2016 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019). Shoqëria vendosi të aplikojë standardin që prej 1 Janar 2019 duke përdorur metodën e modifikimit retrospektiv, duke përdorur thjeshtimet e ofruara nga standardi. Aktivet me të drejtë përdorimit për ndërtesat janë llogaritur sikur rregullat e reja të ishin të aplikueshme që më parë. E drejta e përdorimit për aktivet e tjera është llogaritur bazuar në shumën e detyrimit (e ndryshuar për shpenzimet e parapaguara apo të shtyra). Në aplikimin e SNRF 16 për herë të parë Shoqëria ka përdorur elementët e mëposhtëm të lejuar nga standardi:

- aplikimi i një norme të njëjtë skontimi për qiratë me karakteristika të njëjta,
- mbështetja në përcakime të mëparshme nëse qiratë janë të vështira si një alternative për të performuar,
- një rishikim të daljes nga përdorimi – nuk ka kontrata të veshtira në datë 1 Janar 2019,
- regjistrimi i qirave operative me një periudhë të mbetur për më pak se 12 muaj në 1 Janar 2019 si qira afatshkurtër,
- mospërfshirja e kostove direkte në llogaritjen e Aktive me të drejtë përdorimit në datën e aplikimit fillestarë,
- përdorimi i arsyetimit për të përcaktuar kohëzgjatjen e qirasë kur qiraja përmban opsionin për shtyerje ose përfundim.

Shoqëria ka zgjedhur të mos ripërcaktojë nëse një kontratë është apo përmban një qira në datën fillestare të aplikimit. Për kontratat e hyra në fuqi para datës së aplikimit Shoqëria është bazuar në përcaktimin e parashikuar duke aplikuar SNK 17, *Qiratë*, and KIRFN 4, *Të përcaktosh nëse një kontratë përmban Qira*.

Efekti nga SNRF 16, Qiratë ishte 375,444 Lekë më 1 janari 2019 dhe 3,360,839 Lekë më 31 dhjetor 2019. Shoqëria vendosi të mos njohë asnjë Aktiv me të drejtë përdorimi dhe Detyrimin e qirasë pasi shumat nuk janë materiale.

Standardet e mëposhtme të ndryshuara u bënë efektive për Shoqërinë që nga 1 janari 2019, por nuk patën ndonjë ndikim material në Shoqëri:

- Ndryshimet në SNK 19 "*Plani i ndryshimit, ndalimit ose zgjidhjes*" (lëshuar në 7 shkurt 2018 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- Ndryshimet në SNK 28 "*Interesat afatgjata në bashkëpunëtorë dhe sipërmarrje të përbashkët*" (lëshuar në 12 tetor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- Përmirësimet Vjetore të Ciklit të SNRF 2015-2017 - ndryshime në SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 23 (lëshuar në 12 Dhjetor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2019).
- *Karakteristikat e Parapagimit me Kompensim Negativ* - Ndryshime në SNRF 9 (lëshuar në 12 tetor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2019).
- KIRFN 23 "*Pasiguria mbi trajtimet e tatimit mbi të ardhurat*" (lëshuar në 7 qershor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 Janarit 2019).



5. Interpretime të reja kontabël

Disa standarde dhe interpretime janë publikuar dhe janë të detyrueshme për periudhën prej 1 Janar 2020, por qe Shoqëria nuk i ka aplikuar më herët.

- Ndryshime në Kornizën Konceptuale për Raportimin Financiar (publikuar më 29 Mars 2018 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas 1 Janarit 2020). Kuadri Konceptual i rishikuar përfshin një kapitull të ri për matjen; udhëzime për raportimin e performancës financiare; përkufizime dhe udhëzime të përmirësuara - veçanërisht përcaktimi i një detyrimi; dhe sqarime në fusha të rëndësishme, të tilla si rolet e administrimit, maturisë dhe pasigurisë së matjes në raportimin financiar.
- Shitja ose Kontributi i Aseteve midis një Investitori dhe Ndërmarrjes së Përbashkët të Tij - Ndryshime në SNRF 10 dhe SNK 28 (publikuar në 11 Shtator 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas një date që do të përcaktohen nga BSNK).
- SNRF 17 "Kontratat e Sigurimit" (publikuar më 18 maj 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 Janarit 2021).
- Përkufizimi i një biznesi - Ndryshime në SNRF 3 (publikuar në 22 Tetor 2018 dhe efektive për blerjet nga fillimi i periudhës vjetore të raportimit që fillon në ose pas 1 Janarit 2020).
- Përkufizimi i materialitetit - Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8 (publikuar në 31 tetor 2018 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 Janarit 2020).
- Reforma e normës së interesit - Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7 (publikuar në 26 Shtator 2019 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas 1 Janarit 2020).

Nëse nuk përshkruhet ndryshe më lart, standardet dhe interpretimet e reja nuk pritet të ndikojnë ndjeshëm në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

6. Menaxhimi i rrezikut financiar

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve të saj financiarë:

- rreziku i kredisë
- rreziku i likuiditetit
- rrezikun e tregut

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Shoqërisë ndaj ndonjë prej rreziqeve të mësipërme, objektivave të Shoqërisë, politikave dhe proceseve për matjen e riskut dhe menaxhimin dhe menaxhimin e kapitalit të Shoqërisë. Shënimet e tjera sasiore përfshihen në këto pasqyra financiare. Menaxhimi ka përgjegjësi të plotë për hartimin dhe mbikëqyrjen e kuadrit të menaxhimit të rrezikut të Shoqërisë.

Politikat e menaxhimit të rrezikut të Shoqërisë janë të dizajnuara për të identifikuar dhe analizuar rreziqet që hasin shoqëritë, për të vendosur kufijtë e duhur dhe për të monitoruar rreziqet dhe respektimin e kufijve të përcaktuar. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të pasqyruar ndryshimet në kushtet e tregut dhe aktivitetet e Shoqërisë. Shoqëria, përmes trajnimit dhe standardeve dhe procedurave të saj të menaxhimit synon të zhvillojë një mjedis kontrolli të disiplinuar dhe konstruktiv në të cilin të gjithë punonjësit janë të vetëdijshëm për rolet dhe detyrimet e tyre.

Instrumentet kryesore financiare të shoqërisë përbëhen nga paraja e gatshme dhe ekuivalentët e parasë së gatshme, të arkëtueshmet dhe të pagueshmet e tjera të pagueshme.

Rreziku i kredisë

Rreziku i kreditit është rreziku që njëra prej palëve të mos përmbushë detyrimet e kontratave financiare ose të konsumatorëve, duke shkaktuar humbje financiare. Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë lind si rezultat i shitjeve të produkteve të Shoqërisë në kushte krediti dhe transaksioneve të tjera me palët që sjellin aktivet financiare, duke përfshirë edhe depozitat në banka dhe institucione financiare dhe derivateve. Rreziku i kredisë

SIDERAL SH.P.K.**Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019***(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***6. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**

menaxhohet duke i kërkuar klientit të paguajë urdhrin e shitjes si parapagim. Cilësia e kredisë e një klienti vlerësohet bazuar në një kartë krediti kreditimi me vlerësime gjithëpërfshirëse në kohën e nënshkrimit të një marrëveshjeje. Shuma e shitjes e cila është e papaguar (e arkëtueshme) monitorohet rregullisht. Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë në datën e raportimit është vlera kontabël e secilës klasë të aktiveve financiare. Më 31 dhjetor 2019, Shoqëria nuk është e ekspozuar në mënyrë të konsiderueshme ndaj rrezikut të kredisë. Më 31 dhjetor 2019, Shoqëria nuk ka instrumente financiare kur një klient ose palë në një instrument financiar mund të dështojë në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale. Vlera kontabël e aktiveve financiare paraqet ekspozimin maksimal ndaj rrezikut të kredisë. Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë në datën e raportimit ishte:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Llogari të arkëtueshme	67,694,392	33,514,169
Të arkëtueshme nga punonjësit	-	41,354
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	28,218,991	24,209,041
Totali i ekspozimit nga rreziku i kredisë	95,913,383	57,764,564

Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Shoqëria do të hasë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve që lidhen me detyrimet e saj financiare që duhet të shlyhen me mjete monetare ose me një aktiv financiar tjetër. Qëllimi i Shoqërisë në menaxhimin e likuiditetit është të sigurojë që gjithmonë do të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet në kohë, si në kushte normale ashtu edhe në kushte të vështira, pa ndonjë humbje të papranueshme ose rrezikuar dëmtimin e reputacionit të Shoqërisë. Më poshtë janë paraqitur maturitetet kontraktuale të aktiveve dhe detyrimeve financiare duke përfshirë pagesat e interesave më 31 dhjetor 2019 dhe 2018:

	1-12 muaj	1-5 vite
31 dhjetor 2019		
Aktive financiare		
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	29,209,934	-
Llogari të arkëtueshme	49,644,420	18,049,972
Të tjera të arkëtueshme	-	-
Totali i Aktiveve	78,854,354	18,049,972
Detyrime financiare		
Detyrime kundrejt palëve të lidhura	181,115,407	23,769,514
Llogari të pagueshme dhe të pagueshme të tjera (duke mos përfshirë palët e lidhura)	9,540,284	-
Huatë afatshkurtra	591,485,229	-
Totali i Detyrimeve	782,140,920	23,769,514
Hendeku i likuiditetit neto	(703,286,566)	(5,719,542)

31 dhjetor 2018

Aktive financiare		
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	25,186,659	-
Llogari të arkëtueshme	25,828,144	7,686,025
Të tjera të arkëtueshme	41,354,29	-
Totali i Aktiveve	51,056,157	7,686,025
Detyrime financiare		
Detyrime kundrejt palëve të lidhura	269,628,374	5,911,266
Llogari të pagueshme dhe të pagueshme të tjera (duke mos përfshirë palët e lidhura)	3,244,663	-
Huatë afatshkurtra	615,928,353	-
Totali i Detyrimeve	888,801,390	5,911,266
Hendeku i likuiditetit neto	(837,745,233)	1,774,759

6. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**Rreziku i likuiditetit (vazhdim)**

Shoqëria nuk ka politika dhe procedura formale për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit në nivel lokal, pasi rreziqet menaxhohen në nivel grupi.

Bazuar në tabelën e mësipërme, Shoqëria nuk ka mjete të mjaftueshme qarkulluese për të mbuluar detyrimet aktuale. Detyrimet janë kryesisht me Sidenor Steel Industry S.A Greqi, shoqëri mëmë, dhe SOVEL S.A, palë të lidhura. Prandaj, kërkesa për pagesa të menjëhershme të detyrimeve ndaj palëve të lidhura shmanget. Shqetësimi kryesor është ndaj shumave të pagueshme ndaj palëve të treta, përveç palëve të lidhura.

Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku i ndryshimit të çmimeve të tregut, të tilla si normat e interesit, çmimet e këmbimit dhe çmimet e kapitalit do të ndikojnë në të ardhurat e Shoqërisë ose në vlerën e instrumenteve financiare. Qëllimi i menaxhimit të rrezikut të tregut është menaxhimi dhe kontrolli i ekspozimit ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, duke optimizuar të ardhurat.

Rreziku nga kursit të këmbimit

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kursit të këmbimit si rezultat i luhatjeve të mundshme në kurset e këmbimit në drejtim të transaksioneve në valutë të huaj. Shoqëria ka bilanc të konsiderueshëm në euro kundrejt furnitorëve dhe kreditorëve, të cilat e ekspozojnë Shoqërinë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit. Rreziku i ekspozimit të Shoqërisë ndaj kursit të këmbimit më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është si më poshtë:

	Vlera historike	Lekë	Euro
31 dhjetor 2019			
Llogari të arkëtueshme dhe të arkëtueshme të tjera	503,394,914	435,141,812	68,253,102
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	29,209,934	990,943	28,218,991
Llogari të pagueshme dhe të pagueshme të tjera	(217,040,609)	(10,431,607)	(206,609,002)
Hua afatshkurta	(591,485,229)	-	(591,485,229)
Totali	(275,920,990)	425,701,148	(701,622,138)
31 dhjetor 2018			
Llogari të arkëtueshme dhe të arkëtueshme të tjera	499,677,985	465,715,351	33,962,634
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	25,186,659	977,618	24,209,041
Llogari të pagueshme dhe të pagueshme të tjera	(285,436,360)	(6,551,056)	(278,885,304)
Hua afatshkurta	(615,928,353)	-	(615,928,353)
Totali	(376,500,069)	460,141,913	(836,641,982)

Në përgjithësi, Shoqëria ka hendek të madh të rrezikut nga kursi i këmbimit. Hendeku i madh lidhet kryesisht me hendekun e likuiditetit, në vend të hendekut rrezikut nga kursi i këmbimit (referojuni shënimeve të rrezikut të likuiditetit). Shoqëria nuk ka politika dhe procedura formale për administrimin e këmbimit valutor në nivel lokal, pasi rreziqet menaxhohen në nivel grupi. Më poshtë janë paraqitur kurset e këmbimit të aplikuara gjatë vitit:

	Kursi mesatar i këmbimit		Kursi i këmbimit në fund të vitit	
	2019	2018	2019	2018
1 EUR/LEK	123.01	127.58	121.77	123.42

Analiza e ndjeshmërisë

Në menaxhimin e rrezikut të kursit të këmbimit, Shoqëria synon të zvogëlojë ndikimin e luhatjeve afatshkurtra në fitimet e Shoqërisë. Megjithatë, në periudhën afatgjatë, ndryshimet e përhershme në normat e kursit të këmbimit mund të kenë ndikim në rentabilitetin. Një analizë e ndikimit të parashikuar të ndryshimeve në përqindjen e luhatjeve të vlerës së lekut ndaj monedhave të huaja është paraqitur më poshtë:

SIDERAL SH.P.K.**Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

6. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)**Analiza e ndjeshmërisë së monedhës së huaj**

Analiza e mëposhtme e ndjeshmërisë përcaktohet bazuar në ekspozimin në valutë në datën e raportimit dhe ndryshimet e llogaritura në fillim të vitit financiar të mbajtura konstante gjatë periudhës raportuese. Më poshtë është një përcaktim i efektit të ndryshimeve të kursit të këmbimit në fitimin neto, duke supozuar që të gjitha variablat e tjerë mbeten të vazhdueshme:

	Diferencat në fitimin ose humbjen e vitit	
	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Euro zhvlerësuar/ vlerësuar me 5 %	+/- 35,081,107	+/- 41,832,099

7. Vlera e drejtë

Vlera e drejtë përfaqëson shumën me të cilën mund të shkëmbehet një aktiv ose një detyrim mund të shlyhet në kushtet e tregut të lirë. Vlerat e drejta bazohen në supozimet e menaxhimit të bazuara në profilin e aktiveve dhe detyrimeve.

Detyrimet financiare përcaktohen në norma fleksibël të interesit bazuar në normat e tregut dhe vlera kontabël e tyre është treguesi më i mirë i vlerave të tyre të drejta.

Nuk ka aktive dhe detyrime, vlera e drejtë e të cilave mund të jetë materialisht e ndryshme nga vlera e tyre kontabël. Asnjë nga aktivet ose detyrimet financiare të Shoqërisë nuk matet me vlerën e drejtë.



SIDERAL SH.P.K.

Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

8. Aktive afatgjata materiale

	Toka	Ndërtesa	Makineri dhe pajisje	Autovetura	Pajisje zyre	Totali
Më 1 janar 2018	194,234,664	870,631,534	64,015,712	4,058,240	32,779,221	1,165,719,371
Shtesa	-	41,160	-	-	129,823	170,983
Më 31 dhjetor 2018	194,234,664	870,672,694	64,015,712	4,058,240	32,909,044	1,165,890,354
Shtesa	-	1,437,833	-	-	786,998	2,224,831
Më 31 dhjetor 2019	194,234,664	872,110,527	64,015,712	4,058,240	33,696,042	1,168,115,185
Amortizimi i akumuluar						
Më 1 janar 2018	-	(332,134,786)	(64,015,712)	(4,058,240)	(30,952,747)	(431,161,485)
Amortizimi për vitin	-	(41,496,690)	-	-	(609,064)	(42,105,754)
Më 31 dhjetor 2018	-	(373,631,476)	(64,015,712)	(4,058,240)	(31,561,811)	(473,267,239)
Amortizimi për vitin	-	(41,441,917)	-	-	(741,070)	(42,182,987)
Më 31 dhjetor 2019	-	(415,073,393)	(64,015,712)	(4,058,240)	(32,302,881)	(515,450,226)
Vlera historike						
Më 31 dhjetor 2018	194,234,664	497,041,218	-	-	1,347,233	692,623,115
Më 31 dhjetor 2019	194,234,664	457,037,134	-	-	1,393,161	652,664,959



SIDERAL SH.P.K.**Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019***(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***9. Aktive afatgjata jomateriale**

	Programe Kompjuterike
Më 1 janar 2018	-
Shtesa	217,005
Më 31 dhjetor 2018	217,005
Shtesa	-
Më 31 dhjetor 2019	217,005
Amortizimi i akumuluar	
Më 1 janar 2018	-
Amortizimi për vitin	(13,563)
Më 31 dhjetor 2018	(13,563)
Amortizimi për vitin	(32,551)
Më 31 dhjetor 2019	(46,114)
Vlera historike	
Më 31 dhjetor 2018	203,442
Më 31 dhjetor 2019	170,891

10. Të arketueshme të tjera afatgjata

Shoqëria ka paguar garanci për automjetet që ka më qera në shumën 558,709 Lekë (2018: 448,464 Lekë), garanci e cila do ti kthehet Shoqërisë në përfundim të marrëdhënies ndërmjet tyre.

11. Inventari

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Mallra të përfunduara	108,493,052	151,012,773
Totali	108,493,052	151,012,773

12. Llogaritë e arkëtueshme

Llogarite e arkëtueshme janë si me poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Llogari të arkëtueshme		
Klientë vendas	26,151,230	32,849,339
Klientë të huaj	41,543,162	664,830
Totali	67,694,392	33,514,169

Ditëvonesat e llogarive të arkëtueshme më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 vijon si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Deri në 30 ditë	18,219,241	4,042,708
1 deri në 2 muaj	6,669,750	12,669,553
2 deri në 3 muaj	2,822,299	6,060,251
3 deri në 4 muaj	14,048,223	2,092,832
Mbi 4 muaj	25,934,879	8,648,825
Totali	67,694,392	33,514,169

SIDERAL SH.P.K.**Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019***(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***12. Llogaritë e arkëtueshme (vazhdim)**

Më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 llogaritë e arkëtueshme analizohen si me poshtë:

31 dhjetor 2019	As në vonesë, të pazhvlerësuara	Në vonesë, por të pazhvlerësuara	Të zhvlerësuara	Totali
Vlera bruto	41,955,224	25,739,168	-	67,694,392
Minus: Zhvlerësimi	-	-	-	-
Vlera neto	41,955,224	25,739,168	-	67,694,392

31 dhjetor 2018	As në vonesë, të pazhvlerësuara	Në vonesë, por të pazhvlerësuara	Të zhvlerësuara	Totali
Vlera bruto	24,865,344	8,648,825	-	33,514,169
Minus: Zhvlerësimi	-	-	-	-
Vlera neto	24,865,344	8,648,825	-	33,514,169

Shoqëria ka marrëveshje rregullimi neto me Sidenor Steel Industry S.A, shoqëri mëmë, të cilat janë të zbatueshme në rast të vonesave. Përveç kësaj, legjislacioni i zbatueshëm lejon që një njësi ekonomike në mënyrë të njëanshme të shlyejë llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshmet tregtare që duhet të paguhet, të shprehura në të njëjtën monedhë dhe të papaguara me të njëjtën palë.

Shoqëria administron rrezikun e kredisë duke ndjekur strategjinë e kompensimit të instrumenteve financiare. Shuma e kaluar i takon të arkëtueshmeve nga Sidenor Steel Industry S.A, Shoqëria mëmë. Shoqëria ka gjithashtu detyrime financiare ndaj Sidenor Steel Industry S.A, të cilat janë dukshëm më të larta se shumën e të arkëtueshmeve. Prandaj, Shoqëria nuk pret që të marrë shumën e arkëtueshme pasi kjo shumë do të shënohet me shumën e pagueshme në momentin e shlyerjes.

13. Llogari të tjera të arkëtueshme

Të arkëtueshmet e tjera vijojnë si me poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Llogari të tjera të arkëtueshme		
TVSH e arkëtueshme	432,331,905	462,859,448
Tatim fitimi i parapaguar	2,453,418	2,453,418
Të arkëtueshme nga punonjësit		41,354
Shpenzime të parapaguara	137,083	361,131
Të arkëtueshme të tjera	219,406	-
Totali i llogarive të tjera të arkëtueshme	435,141,812	465,715,351

Shuma e arkëtueshme e TVSH-së përbëhet nga TVSH-ja e gjeneruar nga blerja e materialeve si çeliku dhe telat. Shoqëria importon mallrat e përfunduara nga palët e lidhura, prandaj shumën e TVSH-së paguhet tashmë në favor të porosisë. Në bazë të nenit 69 të ligjit të TVSH-së, Shoqëria ka të drejtë të rimbursojë të gjithë shumën e TVSH-së së paguar.



SIDERAL SH.P.K.**Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019***(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***14. Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre**

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre vijnë si me poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Mjete monetare në bankë në monedhë të huaj	28,218,991	24,209,041
Mjete monetare në bankë në monedhën vendase	897,409	898,031
Mjete monetare në arkë në monedhën vendase	93,534	79,587
Totali i mjeteve monetare dhe ekuivalentët e tyre	29,209,934	25,186,659

Cilësia e kredisë së mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre në banka mund të përmbliiden si më poshtë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

Banka	S&P/FITCH	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
NBG bank	CCC+	-	1,036,176
Alpha bank	CCC+	467,699	157,325
Tirana bank	CCC+	154,323	436,531
Raiffeisen bank	BBB-	14,151,715	9,415,602
Intesa SanPaolo bank	BBB-	2,380,278	155,700
ABI bank	CCC+	517,173	89,871
BKT bank	BBB-	11,445,212	13,815,867
Totali		29,116,400	25,107,072

15. Kapitali**Numri dhe vlera nominale e aksioneve të regjistruara më 31 dhjetor 2019**

Më 31 dhjetor 2019 kapitali aksionar i autorizuar dhe i regjistruar i Shoqërisë ishte 1,160,331,195 Lekë (2018: 1,160,331,195 Lekë), e cila është në pronësi të Sidenor Steel Industry SA me shumën e kapitalit aksionar prej 1,153,947,195 Lekë (99,45%) dhe Halcor SA me shumën e aksioneve kapital prej 6,384,000 Lekë (0,55%).

Aksionerët

Tabela e mëposhtme paraqet strukturën e aksionerëve të Shoqërisë dhe kontributin e tyre të bërë më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018:

	31 dhjetor 2019		31 dhjetor 2018	
Aksioner	Kapitali %	Kontributi në Lekë	Kapitali %	Kontributi në Lekë
Sidenor	99.45%	1,153,947,195	99.45%	1,153,947,195
Halcor	0.55%	6,384,000	0.55%	6,384,000
Totali	100.00%	1,160,331,195	100.00%	1,160,331,195

16. Llogaritë e pagueshme dhe të pagueshme të tjera

Llogaritë e pagueshme dhe të pagueshme të tjera vijnë si me poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Llogari të pagueshme ndaj furnitorëve		
Furnitorë të huaj	204,884,921	275,539,640
Furnitorë vendas	9,540,284	3,244,663
Totali	214,425,205	278,784,303

Të tjera të pagueshme

Kontribute shoqërore dhe shëndetësore të pagueshme	357,363	343,125
Detyrime ndaj tatimit mbi të ardhurat personale	147,620	150,210
Parapagime nga klientët	175,940	353,128
Të pagueshme të tjera	1,934,481	5,805,594
Provizjone	14,583,526	267,729
Totali	17,198,930	6,919,787
Totali	231,624,135	285,704,090

SIDERAL SH.P.K.**Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019***(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***16. Llogaritë e pagueshme dhe të pagueshme të tjera (vazhdim)**

Shuma e llogarive të pagueshme për furnizimet e huaja përbëhet nga mallrat e importuara kryesisht nga shoqëria mëmë, Sidenor Steel S.A, nga palët e tjera të lidhura me grupin. Momentalisht, nuk ekziston rreziku i kërkesës së kthimit të menjëhershëm për llogaritë e pagueshme.

Për më tepër, gjatë vitit 2019, Shoqëria ka kryer pagesa të konsiderueshme ndaj palëve të lidhura që kanë të bëjnë me detyrimet e pagueshme deri më tani.

17. Huatë

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Hua afatshkurtra	591,485,229	615,928,353
Totali	591,485,229	615,928,353

Gjatë vitit 2019, Shoqëria rriti kufirin e overdraft-it me bankën Alpha dhe në fund të vitit shuma e e overdraft-it ishte 591,485,229 Lekë me një maturim 12 muaj nga data e lëvrimit të kredisë. Overdraft-i ka një normë interesi vjetore 4%.

18. Të ardhura nga shitjet

Shitjet vijojnë si me poshtë:

	2019	2018
Mallra të shitura	1,631,812,108	1,465,926,408
Provizion për skontim	(13,601,526)	-
Totali	1,618,210,582	1,465,926,408

Shoqëria blen mallrat përfundimtarë nga Shoqëria mëmë dhe ri-shesin produktet brenda tregjeve vendore dhe të huaja. Shitja e mallrave lidhet me shitjen e produkteve të hekurit, çeliku dhe bakrit, nga të cilat 97,50% janë shitur brenda tregut lokal krahasuar me 2,50% që eksportohen në tregjet e huaja.

19. Kosto e mallrave të shitura

Kostoja e mallrave të shitura përbëhet nga shpenzimet e çmimit të blerjes për mallrat e importuara dhe të transportit nga porosi në depo të Shoqërisë ose në depon e klientëve. Më 31 dhjetor 2019 kostoja e mallrave të shitura ishte 1,487,180 mijë Lekë (2018: 1,414,379 mijë Lekë).

20. Të ardhura të tjera

Të ardhurat e tjera përbëhen si më poshtë:

	2019	2018
Të ardhura nga qiraja	256,765	305,756
Të ardhura nga shërbimet	3,797,191	4,530,701
Totali	4,053,956	4,836,457

Të ardhurat nga qiratë lidhen me hapësirën e magazinës me qira të kompanive të grupeve për të ruajtur produktet e tyre.

21. Shpenzimet e personelit

Shpenzimet e personelit vijojnë si me poshtë:

	2019	2018
Paga bruto	20,696,603	19,273,602
Kontributet shoqërore dhe shëndetësore	2,884,588	2,596,014
Totali	23,581,191	21,869,616



SIDERAL SH.P.K.**Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbylltur më 31 dhjetor 2019***(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***22. Shpenzime të tjera operative**

Shpenzimet e tjera operative vijojnë si me poshtë:

	2019	2018
Penalitete	1,920,856	-
Shpenzime transporti të mallrave	1,437,669	919,656
Shpenzime sigurie	5,040,000	5,040,000
Shpenzime të tjera	2,871,577	3,000,288
Konsulencë teknike për SAP	16,099,961	3,064,864
Shpenzime take	1,930,036	2,294,925
Blerje energjie elektrike, ujë	2,206,481	2,108,275
Shpenzime qeraje financiare	2,707,312	2,070,866
Shpenzime transporti	1,929,594	1,665,607
Shpenzime sigurimi	2,196,820	1,938,758
Shpenzime telefonike	1,390,776	3,698,555
Provizjon	982,000	267,730
Shpenzime marketingu	41,474	46,632
Shërbime kontabilizimi dhe auditimi	2,558,467	2,201,298
Shpenzime legale	793,842	578,949
Shpenzime perkthimi	82,351	353,372
Shpenzime karburanti	310,333	319,928
Mirëmbajtje	1,039,249	926,122
Shpenzime zyre	258,335	124,025
Shpenzime udhëtimi	2,142,806	370,675
Shpenzime përfaqësimi	830,855	571,538
Shpenzime trajnimi	134,874	407,259
Totali	48,905,668	31,969,322

23. Fitime nga kursi i këmbimit nga aktiviteti operativ

Humbjet / Fitimi nga kursi i këmbimit nga aktiviteti operativ vijon si me poshtë:

	2019	2018
Humbjet nga kursi i këmbimit për klientet	(289,347)	(15,677,763)
Fitimi nga kursi i këmbimit për furnitorët	6,115,434	64,784,917
Fitimi nga kursi i këmbimit nga aktiviteti operativ	5,826,087	49,107,154

Shpenzimet financiare dhe të ardhurat përbëhen si më poshtë:

	2019	2018
Të ardhura financiare		
Të ardhura nga kursi i këmbimit	7,638,745	28,138,030
Totali i të ardhurave nga kursi i këmbimit	7,638,745	28,138,030

Shpenzime financiare

Komisione bankare	(4,161,390)	(2,928,364)
Shpenzime interesi	(24,222,216)	(19,973,816)
Humbje nga kursi i këmbimit	(1,710,652)	(6,840,238)
Totali i shpenzimeve financiare	(30,094,258)	(29,742,418)

(Shpenzime) financiare neto	(22,455,513)	(1,604,388)
------------------------------------	---------------------	--------------------

SIDERAL SH.P.K.**Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019***(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***24. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin**

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 vijon si më poshtë:

	2019	2018
Shpenzime për tatim fitimin për periudhën	-	-
Tatimi i shtyrë	4,722,459	4,722,459
Të ardhura nga tatimi i shtyrë	(4,722,459)	-
Totali	-	4,722,459

Shoqëria përcakton tatimin në fund të vitit në përputhje me legjislacionin përkatës tatimor të miratuar aktualisht, i cili përcakton një normë të tatimit mbi të ardhurat prej 15% (2018: 15%).

	2019	2018
Fitim/(Humbje) para tatimit	3,752,854	7,928,487
Tatimi mbi fitimin i llogaritur me 15%	562,928	1,189,273
Shtohet: Shpenzime të panjohura për qëllime të tatimit	3,371,985	1,317,196
Shfrytëzimi i humbjeve tatimore të panjohura më parë, të mbartura	(3,934,913)	(2,506,469)
Humbja/Fitimi tatimor bartur për vitin	-	4,722,459
Shpenzimi për tatim fitimin	-	4,722,459

Në 31 dhjetor 2018 Shoqëria ka zgjedhur të regjistrojë humbjen e mbartur si aktiv tatimorë të shtyrë. Detajet e humbjes tatimore të mbartura janë si më poshtë. Sipas legjislacionit tatimor shqiptar, humbjet mund të mbarten për një periudhë prej tre vjetësh të njëpasnjëshme. Shoqëria ka llogaritur pasuri tatimore të shtyrë për humbjet e krijuara në vitin 2016 në shumën 4,722,459 Lekë të cilat e humbasin efektin në 31.12.2019 (31,483,057 Lekë *15%).

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Humbjet tatimore që mbarten për periudhat pasardhëse do të përfundojnë më: 31 dhjetor 2019	-	31,483,057

25. Palët e lidhura

Shoqëria ka transaksione me palët e lidhura gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë së saj. Tabela më poshtë përmbledh llojin dhe volumin e transaksioneve nga palët e lidhura:

Palët e lidhura	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të ardhura	Shpenzime
Për vitin e mbyllur më				
31 dhjetor 2019				
Të arkëtueshme dhe të tjera	47,106,245	-	44,448,438	-
Të pagueshme dhe të tjera	-	204,810,466	-	1,405,842,886
Totali	47,106,245	204,810,466	44,448,438	1,405,842,886
Për vitin e mbyllur më				
31 dhjetor 2018				
Të arkëtueshme dhe të tjera	6,050,279	-	205,576,923	-
Të pagueshme dhe të tjera	-	275,539,640	-	1,238,535,390
Totali	6,050,279	275,539,640	205,576,923	1,238,535,390

Mallrat janë blerë nga shoqëria mëmë me metodën e kostos plus me një diferencë prej 3.64% (2018: 3.64%). Drejtimi i Shoqërisë përbëhet nga administratorët, respektivisht z. Georgios Tsikandylakis dhe z. Charalampos Bantzalis.

SIDERAL SH.P.K.**Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019***(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***25. Palët e lidhura (vazhdim)**

Pagat dhe përfitimet e menaxhimit kryesor janë si më poshtë:

	2019	2018
Paga dhe bonuse	3,215,636	3,374,288
Kontribute shoqërore dhe shëndetësore	415,880	438,420
Totali	3,631,516	3,812,708

26. Angazhimet dhe të drejta të kushtëzuara*Angazhimet*

	2019	2018
Deri në 1 vit	1,320,000	540,000
Mbi 1 vit por jo më shumë se 5 vite	3,014,000	-
Mbi 5 vite	-	-
Totali	4,334,000	540,000

Angazhimet lidhen me qiratë operative për autoveturat e përdorura nga Shoqëria përgjatë biznesit operativ.

Garancitë

Politika e shitjeve të Shoqërisë kërkon që klientët të parapagujnë për porosinë e mallrave ose ata mund të lëshojnë një garanci për porosinë e kryer me qëllim të dorëzimit të mallrave.

Më 31 dhjetor 2019, Shoqëria nuk ka patur garanci bankare nga klientet (2018: 16,217,500 Lekë ose 120,000 Euro). Në datë 12 shtator 2019, Shoqëria ka lëshuar një Garanci Bankare nga Alpha Bank sh.a në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave në shumën 12,142,000 lekë per Magazinën Doganore me afat skadence 11 shtator 2020.

Detyrime tatimore

Gjatë vitit 2019, Shoqëria ka marrë raportin e auditimit tatimor nr. 8078/6 të datuar më 06/06/2019 mbas kërkesës së Shoqërisë për rimbursim TVSH-je në vlerën 255,448,596 lekë. Në zbatim të shkresës së DPT 15467/2, datë 3 gusht 2018, për periudhat tatimore 06/2015 deri në 12/2017. Ky raport përfshinte njoftimin përkatës të vlerësimit tatimor nr. 8078/5, të datës 6 qershor 2019, të Drejtorisë të Tatimpaguesve të Mëdhenj, nga ku kërkohehin të paguheshin detyrimet tatimore përkatësisht ulje teprices kreditore të TVSH-së në shumën 1,247,237 lekë, gjopa në lidhje me TVSH/Tatim fitimin në shumën 623,619 lekë. Drejtimi i Shoqërisë ka pranuar vlerësimin dhe raportin tatimor. Deri në datën e raportimit të pasqyrave financiare, Shoqëria është rimbursuar nga Drejtoria e Tatimeve për vlerën 178,463,045 Lekë.

27. Ngjarje pas datës së raportimit

COVID-19 është një krizë globale që prek ekonominë në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj. Sektori i çelikut konsiderohet se preket në të njëjtën ose më pak shkallë me shoqëri të tjera në sektorë të ndryshëm. Duhet të theksohet se për shkak të faktit se shumica e klientëve tanë janë shoqëri ndërtimi që veprojnë në ambjent të hapur besohet se kërkesa e klientëve do të mbetet në të njëjtat nivele. Nuk ka asnjë periudhë bllokimi - Shoqëria vazhdon normalisht të operojë.

Drejtimi është i vetëdijshëm për fazën e ndikimit brenda sektorit të çelikut dhe për shkak të natyrës së biznesit, ai lehtë mund të përshtatet me çdo ndryshim në treg. Ndikimi i COVID-19 monitorohet nga afër nga Drejtimi i Shoqërisë.

Nuk ka ngjarje të tjera rëndësishme pas periudhës së raportimit që do të kërkonte ndryshime në informacionin e këtyre pasqyrave financiare.



RAPORTI MBI ECURINË E VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Sideral sh.p.k

Gjatë vitit 2019 është shënuar një ecuri e qëndrueshme për Sideral sh.p.k (në vijim referuar si "SIDERAL" ose "Shoqëria"). Shoqëria i është përgjigjur me sukses sfidave të lidhura me kërkesën për Çelikut dhe Bakrin. SIDERAL shpk është një degë në Shqipëri e SIDENOR Group. Zhvillimi ekonomik i Shqipërisë gjatë viteve të fundit dhe perspektiva e saj për të ardhmen shtyu SIDENOR Group së bashku me partnerët e saj shqiptarë (prej më shumë se 15 vjetësh) për të investuar më shumë në Shqipëri duke krijuar kompaninë SIDERAL shpk.

Më poshtë jepen disa nga treguesit kryesorë financiarë, duke krahasuar periudhën aktuale të raportimit me periudhën e mëparshme të raportimit.

SIDERAL SH.P.K	Viti 2019 (Sasia në Lek)	Viti 2018 (Sasia në Lek)
Të ardhurat Operative (1)	1,622,264,538	1,470,762,865
Kosto e Mallrave të Shitura (2)	(1,487,179,861)	(1,414,378,889)
Shpenzimet Operative (3)	(108,876,310)	(46,851,101)
Rezultatet Operative (4)=(1)+(2)+(3)	26,208,367	9,532,875
Marzhi i Fitimit Operativ (4)= (3)/(1)	1,62%	0,65%

Gjatë vitit 2019, të ardhurat e Shoqërisë nga shitjet e produkteve u rritën me **151,501,673 lekë** ose **10%**.

Fitimi operativ u rrit me **16,675,492 lekë** në krahasim me vitin e shkuar, duke kontribuar në këtë mënyrë në rritjen e Marzhit të fitimit operativ nga 0.65% në 1.62%. Rënia e EBITDA ka ardhur si pasojë e rritjes së shpenzimeve operative gjatë vitit 2019 dhe ujës së të ardhurave nga kursi i këmbimit.

Shoqëria vazhdon të gjenerojë flukse hyrëse parash nga aktivitetet e saj operative në vitin 2019 dhe pret që të vazhdojë edhe në të ardhmen. Shoqëria ishte në gjendje të gjeneronte fitim përpara tatimit prej 3,752,854 Lekë (2018: 7,928,487 Lekë). Drejtimi beson se Shoqëria do të vazhdojë aktivitetin e saj për të ardhmen e parashikueshme dhe do të jetë në gjendje të realizojë aktivet dhe detyrimet dhe angazhimet e saj në rrjedhën normale të biznesit

AKTIVITETE NË FUSHËN E KËRKIMIT DHE ZHVILLIMIT

Sideral shpk operon në tregun Shqiptar si një distributor me risk të limituar, megjithatë Sideral shpk si pjesë e një nga grupi të madh përfiton nga puna kërkimore dhe inovacioni i grupit.

SIDENOR kërkon risi të vazhdueshme me qëllim të vazhdimit të përmirësimit të produkteve që prodhon, zgjidhjeve që ai zhvillon dhe shërbimeve që ai ofron. Në këtë drejtim, SIDENOR investon në kërkime dhe zhvillim. Kompanitë SIDENOR investojnë në linjat kryesore të fabrikës dhe përmirësojnë vazhdimisht linjat ekzistuese për të mbetur konkurrues në tregun

global. Inxhinierët me përvojë rrisin performancën, efektivitetin dhe aftësitë e linjave përtej pritjeve të prodhuesve.

Përmes hulumtimeve të vazhdueshme dhe optimizimit të teknologjisë së proceseve industriale, inxhinierët e ndërmarrjeve SIDENOR forcojnë portofolet e produkteve të tyre me zgjidhje inovative.

Të udhëhequr nga nevojat e klientëve, kompanitë zgjedhin dhe aplikojnë aftësi inxhinierike dhe teknologji të reja në proceset e tyre të prodhimit.

Kompanitë SIDENOR bashkëpunojnë me subjektet shkencore dhe qendrat e shquara ndërkombëtare të kërkimit, duke përfshirë:

- ❖ EHK, Institut für Eisenhüttenkunde, RWTH Aachen, Gjermani
- ❖ Universiteti i Teknologjisë Delft, Hollandë
- ❖ TWI - Instituti i Saldimit, MB
- ❖ Instituti për Korrosionsschutz në Dresden, Gjermani
- ❖ NTUA - Universiteti Kombëtar Teknik i Athinës, Greqi
- ❖ Universiteti i Janinës, Greqi
- ❖ Universiteti i Patras, Greqi
- ❖ Universiteti i Thesalisë, Greqi
- ❖ Universiteti Teknik i Kretës, Greqi
- ❖ Universiteti Aristotel i Selanikut, Greqi
- ❖ Universiteti Demokritus i Thrakës, Greqi
- ❖ Universiteti i Shkencave të Aplikuara Piraeus, Greqi
- ❖ Instituti i Edukimit Teknologjik i Maqedonisë Qendrore, Greqi
- ❖ Instituti Arsimor Teknologjik i Thesalisë, Greqi
- ❖ NCSR Demokritos, Greqi

Kompanitë SIDENOR gjithashtu marrin pjesë në programe dhe shoqata të ndryshme evropiane të kërkimit industrial:

- ❖ Shoqata Evropiane e çelikut (EUROFER)
- ❖ Shoqata Evropiane që përfaqëson prodhuesit dhe përpunuesit e skorjeve metalurgjike (EUROSLAG)
- ❖ Shoqata Evropiane e Saldimit (EWA)
- ❖ Shoqata e Kërkimit dhe Zhvillimit të Nënprodukteve Industriale (EVIPAR)
- ❖ Federata e industrive dhe ndërmarrjeve të riciklimit dhe rikuperimit të energjisë (SEPAN)

Për të fituar eksperiencë të re në teknologjitë në zhvillim dhe për të mbajtur azhurnuar praktikat më të mira, kompanitë SIDENOR mbajnë partneritete afatgjata me udhëheqës globalë, siç janë

- ❖ Daido Steel Co
- ❖ Automatic Wire Machines Spa
- ❖ GMH Gruppe Georgsmarienhütte

Kultura e gjatë e inovacionit në Sidenor është ilustruar në mënyrë të theksuar nga hulumtimet e saj të thella dhe investimet e konsiderueshme në makineri të teknologjisë së lartë përgjatë historisë së saj. Për disa dekada tani, Grupi Sidenor ka mbetur i angazhuar për zhvillimin e teknologjive dhe produkteve inovative për tregun e ndërtimeve të ndërtesave, përmes hulumtimeve të vazhdueshme dhe investimeve të konsiderueshme. Kulmi i përvojës së akumuluar ndërvite është Synthesis™ një teknologji e re, e patentuar ndërkombëtarisht, për përgatitjen industriale të çelikut përforcues. Kompanisë iu dha patenta nga Zyra Evropiane e Patentave.

Ne jemi të inkurajuar dhe krenarë për përparimin që po bëjmë. Ne jemi të emocionuar për atë që e ardhmja do të na rezervojë. Vizioni ynë është të jemi prodhuesi kryesor i produkteve të çelikut përmes njerëzve tanë dhe përsosmërisë sonë teknologjike.

Preferencat e konsumatorit po evoluojnë me shpejtësi, dhe ne po qëndrojmë përpara kurbës me shpërndarjet tona dixhitale, krijimin e qendrave të inovacionit dhe zhvillimin e mëtejshëm të laboratorëve tanë të R&D të klasit botëror. Roli ynë do të jetë në dispozicion të produkteve me cilësi të lartë, të cilat janë hulumtuar dhe prodhuar në standarte të larta dhe promovohen me përgjegjësi - siç kemi kërkuar gjithmonë të bëjmë.

Punonjësit janë pika thelbësore, lidhur me gjithçka që ne bëjmë. Burimet njerëzore janë aset që drejton performancën dhe efikasitetin e Shoqërisë. Shoqëria jonë ka si përparësi të sigurojë një marrëdhënie të fortë punëdhënës – punonjës, bazuar në besimin dhe konsistencën e ndërsjellë në vlerat dhe parimet e korporatave. Ne ofrojmë një mjedis pune gjithëpërfshirës dhe të denjë, duke respektuar kushtet e shëndetit dhe sigurisë dhe të drejtat e njeriut.

Ne ofrojmë mekanizma që promovojnë komunikim të hapur dhe të drejtpërdrejtë me punonjësit tanë. Ne ofrojmë mundësi të barabarta, si për aplikantët ashtu edhe për punonjësit, duke mos lejuar asnjë formë diskriminimi në lidhje me gjininë, kombësinë, racën, fenë, statusin e familjes ose tjetër, dhe duke promovuar transparencë dhe meritokraci.

Me 31 Dhjetor 2019, numri i punonjësve të Sideral sh.p.k ishte 15. Gjatë vitit 2019 shpenzimet e përfitimit të punonjësve arritën shumën **23,581,191 lekë**, sikurse shpjegohet në Shënimin 23 të Pasqyrave Financiare.

Zhvillimi i punonjësve tanë është një përgjegjësi që na ndihmon të ruajmë një personel me kualifikim të lartë. Në fushën e trajnimeve, në vitin 2019, SIDERAL ka kontribuar në zhvillimin e punonjësve tanë, duke siguruar trajnime të vazhdueshme lidhur me aftësitë teknike dhe të menaxhimit. Trajnimet që ofrojmë (përveç sa parashtroam më sipër në kapitullin lidhur me Shëndetin dhe Sigurinë) janë fokusuar në përmirësimin e “aftësive të buta” të punonjësve, në lidhje me punën në ekip dhe ndërtimin e ekipit, komunikimin efektiv, aftësitë e prezantimit, përmirësimin e njohurive të tyre teknike dhe gjithashtu për të promovuar vlerat e Shoqërisë.

a) Rreziqet e biznesit

Lidhur me produktet e çelikut, vërehet se lënda e parë kryesore për prodhimin e produkteve të çelikut është skrap. Skrapi e ka burimin nga riciklimi i materialeve që vijnë në fund të jetës së tyre. Disponueshmëria e skrapit dhe çmimet ndërkombëtare të skrapit janë çështje

kryesore në biznesin e Sidenor Group. Luhajtja e çmimeve të skrapit ndikon ndjeshëm në koston e produkteve, si dhe në çmimet e produkteve përfundimtare.

SIDERALE SH.P.K. nuk është i përfshirë në aktivitetin e prokurimit të kryer nga Fabrikat dhe nuk ka risk prodhimi.

SIDENOR INDUSTRIAL S.A., SOVEL S.A., STOMANA INDUSTRY S.A., DOJRAN STEEL LLCOP, ERLIKON S.A. dhe ELVALHALCOR S.A. janë përgjegjës për të gjitha funksionet që lidhen me veprimtarinë prodhuese të produkteve të saj të shpërndara në tregun shqiptar.

b) Blerja e aksioneve të veta

Kapitali aksionar i autorizuar dhe i regjistruar i Shoqërisë është 1,160,331,195 Lekë (2018: 1,160,331,195 Lekë), e cila është në pronësi të Sidenor Steel Industry SA me shumën e kapitalit aksionar prej 1,153,947,195 Lekë (99,45%) dhe Elvalhalcor SA me shumën e aksioneve kapital prej 6,384,000 Lekë (0,55%).

Gjatë vitit 2019 nuk ka pasur ndryshime në strukturën e kapitalit të shoqërisë apo në vlerën e kontributit aksionar.

c) Degët e Shoqërisë

Shoqëria zhvillon aktivitetin në adresën Durres Xhafzotaj, Borake, Autostrada Tirane-Durres, Kilometri 24, ndertese te Zona Kadastrale nr.1242, Nr.Pasurie 34/27, volumi 3, faqe 137. Shoqëria nuk ka bija të saj.

d) Politikat dhe objektivi i administrimit të riskut financiar, ekspozimi i Shoqërisë ndaj risqeve financiare & sasive të riskut

Politikat dhe Objektivat për administrimin e rreziqeve financiare, si dhe sasitë përkatëse, përfshihen në shënimet e Pasqyrave Financiare.

e) OBJEKTIVAT E SHOQËRISË PËR VITIN 2020

- Të vazhdojë të jetë një nga importuesit kryesor të produkteve të çelikut.
- Te vazhdojë të tregtojë produkte të çelikut me cilësi të lartë dhe ofrimi i shërbimeve me vlerë të shtuar për klientët tanë.
- Shpërblim dhe një ndjenjë krenarie për punonjësit tanë
- Kthime të kënaqshme për investitorët tanë.
- Pajtueshmërinë me legjislacionin në fuqi dhe zbatimin e plotë të standardeve, politikave, udhëzimeve të brendshme dhe procedurave të zbatueshme për kompaninë, si dhe angazhime të tjera, që rrjedhin nga marrëveshje vullnetare, të miratuara dhe të pranuar nga Grupi,
- Zhvillimi i marrëdhënieve të besimit të ndërsjellë me palët e interesuara është thelbësore për përmbushjen me sukses të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm,
- Sigurimi i një ambienti të sigurt dhe të shëndetshëm pune për njerëzit tanë, partnerët dhe çdo palë të tretë të përfshirë,
- Mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe sigurimin e një mjedisi pune me mundësi të barabarta, pa asnjë diskriminim,

- Komunikim i hapur, i bazuar në transparencë, me të gjithë palët e interesuara,
- Përpjekjet e vazhdueshme për të zvogëluar ndikimin në mjedisit
- Përpjekje e vazhdueshme për krijimin e vlerës së shtuar për palët e interesuara

RAPORTI I DREJTIMIT TE BRENDSEHEM

a) Qeverisja e Korporatës

Misioni ynë është prodhimi i sigurtë i produkteve të çelikut dhe ofrimi i shërbimeve me vlerë të shtuar për klientët tanë, kthime të kënaqshme për investitorët tanë, shpërblime dhe një ndjenjë krenarie për punonjësit tanë, marrëdhënie afatgjata me furnitorët tanë, dhe qëndrueshmëri dhe zhvillim mjedisor për komunitetet lokale dhe shoqërinë në përgjithësi.

Kohët e fundit, ne jemi duke u përpjekur për përsosmëri. Objektivi i Sidenor është të kënaqë plotësisht klientët e tij duke arritur vazhdimisht reagimet e tyre të dëshiruara brenda afateve të përcaktuara.

Menaxhimi i Kompanisë i është kushtuar një filozofie të përpiket vazhdimisht të:

- ❖ të përmirësojë produktet, mjetet e prodhimit dhe proceset e tij në terma cilësor;
- ❖ të rinovojë më tej pajisjet e saj të prodhimit;
- ❖ të përmirësojë komunikimin, dhe të ushqejë frymën e ekipit dhe bashkëpunimin midis departamenteve të ndryshme të kompanisë, përfshirë furnitorët dhe klientët; dhe
- ❖ përputhen në mënyrë rigorozë me të gjitha ligjet në fuqi

Përgjegjësitë e secilit ekzekutiv në të gjitha nivelet e administratës përfshijnë:

- ❖ promovimi i Politikës së Cilësisë dhe sigurimi që kjo politikë të kuptohet plotësisht, zbatohet dhe mirëmbahet
- ❖ alokim i veçantë i përgjegjësiave për Cilësinë;
- ❖ identifikimin e nevojave dhe kërkesave të klientëve;
- ❖ përcaktimi i objektivave të lidhura me cilësinë si funksionaliteti, aftësia dhe besueshmëria e produkteve;
- ❖ kontabiliteti i kostove të lidhura me cilësinë;
- ❖ rishikimin dhe zbatimin efektiv të Sistemit të Cilësisë dhe programeve për të arritur të gjitha objektivat dhe parashikimin e problemeve;
- ❖ mirëmbajtja, kontrolli dhe përmirësimi i vazhdueshëm i proceseve të prodhimit;
- ❖ identifikimin e nevojave për trajnim dhe planifikimin e trajnimeve të vazhdueshme në punë të stafit; dhe
- ❖ një analizë serioze dhe e thelluar e të gjitha ankesave me qëllim të sigurimit të kënaqësisë afatgjatë të klientit.

Sistemi i Cilësisë i SIDENOR mbështetet në përkushtimin e plotë të menaxhimit për një cilësi ideale dhe përmbytjen e plotë të pritshmërisë së klientëve, si dhe besimin e Kompanisë në tërësi që Cilësia dhe Inovacioni janë dy parakushtet për qëndrueshmëri dhe përparim në këtë epokë të re ekonomike.

Të gjithë punonjësit, specialistët, drejtorët dhe personat e tjerë që veprojnë në emër të Kompanisë pritet të zbatojnë ligjet, rregullat dhe rregulloret qeveritare që zbatohen për bizneset e saj dhe të respektojnë standardet dhe kufizimet që ata vendosin. Të gjithë punonjësit janë personalisht përgjegjës për respektimin e ligjit dhe respektimin e udhëzimeve të brendshme në mjedisin e tyre të punës. Prioriteti kryesor i kompanisë është të respektojë dispozitat ligjore dhe udhëzimet e brendshme, si dhe të sigurojë sjelljen e ligjshme dhe korrekte që rezultojn. Në rast konflikti midis ligjit dhe parimeve të përfshira në këtë kod, ligji do të mbizotërojë.

Në përgjithësi, SIDERAL SH.P.K është një organizatë shitblerjeje që kryen shumë prej funksioneve që kanë të bëjnë me shpërndarjen dhe tregtimin e produkteve në tregjet në të cilat operon shoqëria. SIDERAL ka një shkallë të ulët të përfshirjes në vendimet strategjike të marketingut, të cilat ndërmerren nga Grupi.

Si rrjedhim, për qëllimet e kësaj analize, SIDERAL konsiderohet të jetë një distributor rutinë në kontekstin e transaksioneve në shqyrtim.

Qëllimet tona janë të minimizojmë ndikimin në mjedis, të përmirësojmë vazhdimisht performancën tonë mjedisore dhe të promovojmë përgjegjësinë mjedisore në kulturën tonë. Kompania merr një qasje paraprake ndaj sfidave mjedisore duke ndërmarrë nisma për të promovuar një përgjegjësi më të madhe mjedisore, duke inkurajuar zhvillimin dhe përfshirjen e teknologjive miqësore me mjedisin. Kompania vepron dhe është e certifikuar në përputhje me standardet mjedisore të njohura ndërkombëtarisht (ISO 14001). Ne kontrollojmë në mënyrë rutinore, ndjekim dhe raportojmë për performancën mjedisore të Kompanisë, me theks të veçantë në vlerësimin e rreziqeve të mundshme të produkteve dhe operacioneve ekzistuese dhe të ardhshme.

SIDENOR, për të forcuar operacionin e tij të Zhvillimit të Qëndrueshëm, ka krijuar politika specifike dhe implementon sisteme dhe procese të përshtatshme menaxhimi që mbështesin funksionimin përgjegjës dhe përcaktojnë se si janë arritur objektivat e Kompanisë. Në veçanti, SIDENOR, përveç të tjerash, ka krijuar dhe zbaton politikat dhe kodet e mëposhtme:

- Rregullat e brendshme të funksionimit
- Politika e zhvillimit të qëndrueshëm
- Politika e Shëndetit dhe Sigurisë në Punë
- Politika mjedisore
- Burimet Njerëzore dhe Politika e të Drejtave të Njeriut
- Politika e Cilësisë
- Kodi i Etikës dhe Etika e Biznesit

Menaxhimi i integruar i kompanisë kryhet përmes Sistemeve të Menaxhimit që ai implementon. Veçanërisht,

SIDENOR zbaton sistemet e mëposhtme të certifikuara:

- Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë, sipas standardit ISO 9001.
- Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit, sipas ISO 14001.
- Sistemi i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë, në përputhje me standardin OHSAS 18001

b) Menaxhimi i risqeve dhe mundësive

SIDENOR Grup zbaton një sistem administrimi të organizuar dhe përshtatur shkëlqyeshëm për nevojat e intustisë të çelikut aktuale, të certifikuara me standartin ISO 9001:2008, i cili siguron se prodhimi i produkteve është në përputhje me të gjitha standartet dhe rregullat si dhe me kërkesat e vecanta të klientëve.

Cilësia e produkteve të çelikut kontrollohet vazhdimisht në të gjitha fazat e procesit të prodhimit, nga sektori i Kontrollit të Cilësisë së shoqërisë me qëllim përputhjen me të gjitha standartet dhe rregullat më të rrepta . Procesi i Kontrollit të Cilësisë përfshin analiza të shumta kimike, kontrole metalografike, matje të karakteristikave gjeometrike dhe testime mekanike, të cilat kryen në laboratorët me pajisje të përkryera, për analiza kimike dhe prova mekanike të shoqërisë nga një personel me kualifikim të lartë.

Rrjeti i integruar i zbulimit të radioaktivitetit përdorur nga Grupi SIDENOR, për produktet e papërpunuara si dhe për produktet përfundimtare, siguron produkte çeliku të sigurta pa radioaktivitet.

- SIDENOR-ISO9001
- SIDENOR-ISO9001-IQNET
- SIDENOR-B500C-BARS
- SIDENOR-B500A-MESH
- SIDENOR-B500C-COILS
- SIDENOR_COIL_B500B_DE
- SIDENOR_B500B_DE
- SIDENOR_B500B_BG
- SIDENOR_B500C_BG
- SIDENOR_BS1500S_RO
- SIDENOR_OB37_RO
- SIDENOR_COIL_PC52_RO
- SIDENOR_B235_BG
- SIDENOR_M/B_S235JR_DE
- SIDENOR_M/B_275JR_DE
- SIDENOR_M/B_S355J0_DE
- SIDENOR_M/B_S355J2_UK
- SOVEL-ISO9001-IQNET-products
- SOVEL-ISO9001-IQNET-port
- SOVEL-ISO 9001-PLANT B
- SOVEL-ISO 9001- PLANT A
- SOVEL-ISO9001-CARES
- SOVEL-B500C-BARS
- SOVEL_B500C_MESH

- SOVEL_B500A_MESH
- SOVEL_B500C_COIL
- SOVEL_B500C_BG
- SOVEL_B500B_RO
- SOVEL_B500B_BG
- SOVEL_B500B_CR
- SOVEL_B500B_DE
- SOVEL_COIL_B500B_DE
- SOVEL_COIL_PC52_RO
- SOVEL_B450C_IT
- SOVEL_460B_B500B_UK
- SOVEL_PC52_RO
- STOMANA-ISO9001-TUV

Ekipi i menaxhimit i Sideral sh.p.k vlerëson rreziqet sociale, mjedisore, drejtuese dhe financiare, me të cilat Shoqëria mund të përballë në kuadrin e sfidave të vendit, rajonit dhe më tej. Shoqëria administron rreziqet përmes:

- Kontrolleve dhe sistemeve të brendshme, në përputhje me kërkesat e Sistemeve të Menaxhimit;
- Krijimit të komiteteve të ndryshme në Shoqëri, për të adresuar sfida dhe çështje të ndryshme.

c) Vlerat e SIDERAL-s

Vlerat e SIDERAL-s burojnë drejtpërdrejt nga parimet, besimet dhe vizioni.

Ne jemi të fokusuar për produkte cilësore. Ne përqëndrohemi në epërsi teknologjike dhe optimizim të kostos.

Kompania respekton dhe mbështet të drejtat e njeriut të njohura ndërkombëtarisht dhe zbaton politika të shpërblimit të drejtë, meritokracisë dhe mundësive të barabarta, pa diskriminim, për të gjithë punonjësit e saj.

d) Kontrollat e brendshme dhe sistemet e menaxhimit të riskut, në lidhje me raportimin financiar

Elementët kryesorë të sistemit të kontrolleve të brendshëm, të përdorura për të shmangur gabimet në përgatitjen e pasqyrave financiare dhe për të siguruar një informacion të besueshëm financiar:

- Mekanizmi i sigurimit në lidhje me integritetin e pasqyrave financiare të Shoqërisë, përbëhet nga një kombinim i proceseve të vendosura të administrimit të riskut, aktiviteteve të zbatuara lidhur me kontrollin financiar, teknologjisë së informacionit të përdorur për informacionin dhe informacionit financiar të përgatitur, komunikuar dhe

monitoruar. Shoqëria përgatit dhe rishikon në baza mujore të dhëna financiare dhe jo-financiare, të cilat analizohen nga niveli drejtues i Shoqërisë, në mënyrë periodike.

- Shoqëria përdor një paketë të plotë software SAP, për të monitoruar veprimet e saj operacionale dhe të kontabilitetit. Kjo zgjidhje softuerësh ofron mënyrën më të sigurt dhe të përparuar të regjistrimit dhe raportimit të të gjitha aktiviteteve të Shoqërisë, në mënyrë të saktë dhe korrekte.
- Shoqëria ka angazhuar auditorë të jashtëm, që të rishikojnë pasqyrat financiare të gjashtë-mujorit dhe të auditojnë pasqyrat financiare vjetore.

Të gjitha sa më sipër sigurojnë që pasqyrat financiare të Shoqërisë japin informacion të besueshëm dhe të saktë.

Administratori

Charalampos Bartzelis



RAPORTIMI I PAGESAVE QË U BËHEN INSTITUCIONEVE SHETETËRORE

Raporti i mëposhtëm është përgatitur në përputhje me nenin 21 të Ligjit për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare Nr. 25/2018, datë 10.05.2018.

Tabela e mëposhtme tregon pagesat e kryera tek autoritetet tatimore shtetërore, sipas llojit të treguar të taksave ose kategorive.

	Shuma
Kontributet e Sigurimeve Shoqërore	ALL 4,130,355
Kontributet e Sigurimeve Shëndetësore	ALL 711,699
Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi (TAP)	ALL 2,186,274
Total Kontribute dhe TAP (1)	ALL 7,028,328
Tatim ne burim (2)	ALL 5,379
Total paguar taksa për tatim taksat (1)+(2)	ALL 7,033,707

** Shumat e mësipërme paraqesin pagesat aktuale të bera nga shoqëria gjatë vitit kalendarik që është mbyllur me 31 Dhjetor 2019.

Administratori

Charalampos Bartzelis

